



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i Lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 30 prill 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Qasje në Versionet Konfidenciale të
Aktgjykimeve në Çështjen KSC-BC-2020-05**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Çështja Gjyqësore 05:
Mbrojtëses së Viktimave
Ani Pues

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Salih Mustafës
Julius von Bone

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21(2), 4 (c) dhe (6), 23 dhe 40(2) dhe (6) të Ligjit nr. 05/L 053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 81(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 shkurt 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") i dorëzoi Kryetares së Dhomave të Specializuara ("Kryetarja") kërkesë ("Kërkesa")¹ për qasje në versionet konfidenciale të aktgjykimit të trupit gjykues² dhe aktgjykimit të apelit³ në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-05 ("Çështja 05" dhe "Aktgjykimet e Çështjes 05").
2. Më 12 shkurt 2024, Kryetarja ia referoi Kërkesën këtij Trupi Gjykses dhe urdhëroi Njësine për Administrimin e Gjykatës që të protokollonte Kërkesën para këtij Trup Gjykses ("Vendimi i Kryetares").⁴
3. Më 13 shkurt 2024, Kërkesa u protokollua para këtij Trupi Gjykses.⁵
4. Nuk u dorëzuan përgjigje ndaj Kërkesës.

¹ KSC-CA-2023-02/F00042/COR (ndërkohë e protokolluar gjithashtu edhe si KSC-BC-2020-06/F02118/COR; shih gjithashtu më poshtë, para. 3 dhe poshtëshënimin 5), Prokurorja e Specializuar, Version i Korrigjuar i Kërkesës së Prokurorisë për Qasje në Versionet Konfidenciale të Aktgjykimit të Trupit Gjykses dhe Aktgjykimit të Apelit, 9 shkurt 2024 (data e origjinalit: 8 shkurt 2024).

² KSC-BC-2020-05/F00494, Trupi Gjykses I, Aktgjykim ("Aktgjykimi i Çështjes 05"), 16 dhjetor 2022, konfidencial (versioni publik i redaktuar më tej u lëshua më 8 qershor 2023, F00494/RED3/COR).

³ KSC-CA-2023-02/F00038, Paneli i Gjykatës së Apelit, Aktgjykimi i Apelit, 14 dhjetor 2023, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u lëshua të njëjtën ditë, F00038/RED).

⁴ KSC-CA-2023-02/F00043, Kryetarja, Vendim për Referimin e Një Kërkesë Trupit Gjykses II, 12 shkurt 2024.

⁵ Shih F02118/COR (shih më lart, poshtëshënimin 1).

5. Më 18 prill 2024, pas këshillimeve të Trupit Gjykses,⁶ gjykatësit e Trupit Gjykses I dhe gjykatësit e Panelit të Gjykatës së Apelit u shprehën se, sipas tyre, nuk ka arsye që redaktimet në versionet e redaktuara publike të Aktgjykimeve të Çështjes 05 të mos hiqen për Trupin Gjykses ose palët dhe Mbrojtësin e Viktimave në këtë çështje gjyqësore ("Çështja 06").⁷

II. PARASHTRIMET

6. ZPS-ja kërkon që ky Trup Gjykses dhe palët dhe Mbrojtësi i Viktimave në Çështjen 06 të lejohen të kenë qasje në versionet konfidenciale të Aktgjykimeve të Çështjes 05 dhe t'i përdorin ato në mënyrë konfidenciale.⁸ Sa i përket bazës ligjore të Kërkesës, ZPS-ja i referohet rregullës 82(1) dhe (5).⁹ ZPS-ja parashtrohet se: (i) Kërkesa është bërë për një qëllim juridik konkret dhe legjitim, veçanërisht në lidhje me kërkesën e mundshme për konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në Aktgjykimet e Çështjes 05; dhe se (ii) miratimi i Kërkesës nuk ndikon në masat mbrojtëse në fuqi dhe në fund mund të ndihmojë kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit në Çështjen 06.¹⁰ ZPS-ja gjithashtu parashtrohet se provat e cituara dhe të diskutuara në Aktgjykimet e Çështjes 05 janë nxjerrë tashmë në Çështjen 06.¹¹

III. DISKUTIM

7. Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja kërkon autorizim që ky Trup Gjykses, palët dhe pjesëmarrësit në Çështjen 06, të kenë qasje në versionet konfidenciale të Aktgjykimeve

⁶ KSC/CHA/BC/TP2/012, Trupi Gjykses II, *Memorandum: Këshillime në lidhje me Qasjen në Versionet Konfidenciale të Aktgjykimit të Trupit Gjykses dhe Aktgjykimit të Apelit në Çështjen KSC-BC-2020-05/KSC-CA-2023-02*, 5 prill 2024, konfidencial dhe *ex parte*.

⁷ KSC/CHA/BC/TP1/MVF/018, Trupi Gjykses I, *Memorandum: Këshillime në lidhje me Qasje në Çështjen KSC-BC-2020-06 në Versionin Konfidencial të Aktgjykimit të Trupit Gjykses në Çështjen KSC-BC-2020-05*, 18 prill 2024, konfidencial dhe *ex parte*; Paneli i Gjykatës së Apelit, *Memorandum: Këshillime në lidhje me Qasje në Çështjen KSC-BC-2020-06 në Versionin Konfidencial të Aktgjykimit të Apelit në Çështjen KSC-CA-2023-02*, 18 prill 2024, konfidencial dhe *ex parte*.

⁸ Kërkesa, para 1, 4. *Shih gjithashtu Kërkesën*, para. 3.

⁹ Kërkesa, para. 1.

¹⁰ Kërkesa, para. 1-3.

¹¹ Kërkesa, para. 3.

të Çështjes 05 dhe t'i përdorin ato në mënyrë konfidenciale. Trupi Gjykses do të vlerësojë Kërkesën veçanërisht duke mbajtur parasysh të drejtën e Mbrojtjes për të marrë të gjitha materialet dhe provat ose faktet relevante, sipas nenit 21 (6), si dhe nevojën për të garantuar mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve, sipas nenit 23. E drejta e Mbrojtjes për të marrë të gjitha materialet dhe provat ose faktet relevante në përgjithësi zbatohet nëpërmjet detyrimeve që ka ZPS-ja për nxjerrjen e materialeve sipas Ligjit dhe Rregullores. Megjithatë, kjo nuk paragjykon diskrecionin e Trupit Gjykses që të miratojë qasje në pjesë të dokumentacionit të një çështjeje të mbyllur ose të përfunduar gjyqësore.¹²

8. Në mungesë të një standardi konkret për vlerësimin e kërkesave për qasje në informacion konfidencial në një çështje gjyqësore tjetër, Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme t'u referohet juridiksioneve jashtë Dhomave të Specializuara. Në veçanti, Trupi Gjykses përdor standardin për qasje në materiale konfidenciale të një çështjeje gjyqësore tjetër, të përcaktuar nga tribunalët *ad hoc*, përkatësisht se: (i) dokumentet në lidhje me të cilat kërkohet qasje duhet të jenë identifikuar ose përshkruar për nga natyra e përgjithshme e tyre; dhe (ii) duhet të tregohet se qasja në ato dokumente kërkohet për një qëllim juridik legjitim.¹³

¹² Shih gjithashtu KSC-BC-2020-05, RAC001/F00009, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes në Çështjen KSC-BC-2020-06 për Qasje në Materiale Konfidenciale të Çështjes Prokurori k. Salih Mustafës*, 1 shkurt 2022, para. 23.

¹³ Shih, për shembull, ICTY, *Prosecutor v. Hadžić*, IT-04-75-PT / IT-95-13/1-A, [Decision on Motion on Behalf of Goran Hadžić Seeking Access to Confidential Material in Prosecutor v. Mrkšić et al.](#), 22 March 2012, para. 5; *Prosecutor v. Hadžić*, IT-04-75-PT / IT-95-13a-T, [Decision on Motion on Behalf of Goran Hadžić Seeking Access to Confidential Material in Prosecutor v. Slavko Dokmanović](#), 22 March 2012, para. 5; *Prosecutor v. Hadžić*, IT-04-75-PT / IT-02-54-T, [Decision on Motion on Behalf of Goran Hadžić Seeking Access to Confidential Material in Prosecutor v. Slobodan Milošević related to Croatia](#), 22 March 2012, para. 5; *Prosecutor v. Hadžihasanović et al.*, IT-01-47-PT, [Decision on Motion by Mario Čerkez for Access to Confidential Supporting Material](#), 10 October 2001, para. 10; *Prosecutor v. Blaškić*, IT-95-14-A, [Decision on Appellants Dario Kordić and Mario Čerkez's Request for Assistance of the Appeals Chamber in Gaining Access to Appellate Briefs and Non-Public Post-Appeal Pleadings and Hearing Transcript Filed in the Prosecutor v. Blaškić](#), 16 May 2002, para. 14; *Prosecutor v. Brđanin*, IT-99-36-A, [Decision on Mićo Stanišić's Motion for Access to All Confidential Materials in the Brđanin Case](#), 24 January 2007, para. 10; *Prosecutor v. Martić*, IT-95-11-A, [Decision on Motion by Jovica Stanišić for Access to Confidential Testimony and Exhibits in the Martić Case Pursuant to Rule 75\(G\)\(i\)](#), 22 February 2008, para. 9; ICTR, *Prosecutor v. Rutaganda*, ICTR-96-3-R, [Decision on Georges A.N. Rutaganda's Appeal Against Decision on Request for Closed Session Testimony and Sealed Exhibits](#), 22 April 2009, para. 10.

9. ZPS-ja ka identifikuar dokumentet për të cilat kërkon qasje, përkatësisht Aktgjykimet e Çështjes 05, dhe rrjedhimisht elementi i parë i këtij standardi është përmbushur.

10. Në lidhje me qëllimin juridik legjitim, Trupi Gjykses vëren se Çështja 05 dhe Çështja 06 përkojnë konsiderueshëm njëra me tjetrën.¹⁴ Gjithashtu, Trupi Gjykses mban parasysh parashtrimet e ZPS-së se: (i) ZPS-ja mund të dorëzojë kërkesë për konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara që burojnë nga Aktgjykimet e Çështjes 05; dhe se (ii) konstatimet gjyqësore përkatëse janë të redaktuara në versionet e redaktuara publike të Aktgjykimeve të Çështjes 05.¹⁵ Që të mund të bëjnë parashtrime në lidhje me kërkesën e mundshme për konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara, dhe për vlerësimin e një kërkesë të tillë, ky Grup Gjykses dhe palët dhe pjesëmarrësit në Çështjen 06 duhet të kenë qasje në versionet konfidenciale të Aktgjykimeve të Çështjes 05. Për këtë arsye, ekziston një qëllim juridik konkret dhe legjitim për qasjen që kërkon ZPS-ja.

11. Sa i përket mbrojtjes së dëshmitarëve dhe viktimave, Trupi Gjykses e kupton se, pavarësisht se deri me tani asnjë nga dëshmitarët e Çështjes 05 nuk ka dëshmuar në Çështjen 06,¹⁶ identitetet e dëshmitarëve në Çështjen 05 që janë dëshmitarë edhe në Çështjen 06 janë të njohura për Mbrojtjen në Çështjen 06.¹⁷ Gjithashtu, ZPS-ja pohon se në Çështjen 06 ka nxjerrë prova që citohen dhe diskutohen në Aktgjykimet e Çështjes 05, sipas rregullave 81 (1)(b), 102 dhe 103, sipas rastit. Nga Kërkesa, Trupi Gjykses gjithashtu kupton se ZPS-ja nuk mendon se miratimi i Kërkesës do të paraqiste rrezik për dëshmitarët ose viktimat, dhe nuk

¹⁴ *Shih* F02112, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtësit për Konstatim sipas Nenit 28(4)(b)(i) të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët (Konflikt Interesash)*, 8 shkurt 2024, para. 23-25.

¹⁵ Kërkesa, para. 2.

¹⁶ Për dëshmitarët e ZPS-së në Çështjen 05, *shih* Aktgjykimin, para. 58-137. Për dëshmitarët e Mbrojtjes në Çështjen 05, *shih* Aktgjykimin, para. 139-223.

¹⁷ Sa u përket dëshmitarëve që u ishte miratuar shtyrje e nxjerrjes së identitetit për Mbrojtjen, identitetet e tyre u bënë të ditura më 3 prill 2023 ,ose rreth kësaj date, *shih, për shembull*, Paketat nr. 739-741 të materialeve të nxjerra. *Shih gjithashtu* F01394, Prokurori i Specializuar, Njoftim për Nxjerrjen e Vonuar të Identiteteve të Dëshmitarëve, 24 mars 2023, konfidencial.

është dorëzuar asnjë përgjigje ndaj Kërkesës që ngre këtë shqetësim. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se sipas rregullës 81(1)(a), masat mbrojtëse në Çështjen 05 mbeten në fuqi *mutatis mutandis* në Çështjen 06, përveç nëse ndryshohen në përputhje me rregullën 81. Për më tepër, gjykatësit e Trupit Gjykses I dhe gjykatësit e Panelit të Gjykatës së Apelit vlerësojnë se nuk ka arsye që redaktimet në versionet e redaktuara publike të Aktgjykimeve të Çështjes 05 të mos hiqen për Trupit Gjykses ose palët dhe Mbrojtësin e Viktimave në Çështjen 06.¹⁸

12. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se miratimi i Kërkesës do të ishte në përputhje me nevojën për të garantuar mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, me kusht që Aktgjykimet e Çështjes 05 të mbeten konfidenciale në Çështjen 06.

13. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses miraton Kërkesën. Zyra Administrative udhëzohet të sigurojë që këtij Trupi Gjykses, Mbrojtjes dhe Mbrojtësit të Viktimave në Çështjen 06 t'u lejohet qasje në versionet konfidenciale të Aktgjykimeve të Çështjes 05 në sistemin elektronik *Legal Workflow*.

14. Trupi Gjykses u kujton palëve dhe pjesëmarrësve klasifikimin konfidencial të këtyre versioneve të Aktgjykimeve të Çështjes 05 dhe se, sipas rregullës 82(1)(b), pjesët konfidenciale të Aktgjykimeve të Çështjes 05 nuk i bëhen të njohura publikut.

IV. VENDIM

15. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** Kërkesën;
- b) **UDHËZON** Zyrën Administrative të sigurojë që këtij Trupi Gjykses, Mbrojtjes dhe Mbrojtësit të Viktimave në Çështjen 06, t'u lejohet qasje në versionet konfidenciale të Aktgjykimeve të Çështjes 05 në sistemin

¹⁸ *Shih* më lart, para. 5.

elektronik *Legal Workflow*; dhe

- c) **U KUJTON** palëve dhe pjesëmarrësve klasifikimin konfidencial të këtyre versioneve të Aktgjykimeve të Çështjes 05 dhe se, sipas rregullës 82(1)(b), pjesët konfidenciale të Aktgjykimeve të Çështjes 05 nuk i bëhen të njohura publikut.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E martë, 30 prill 2024

Në Hagë, Holandë.